

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjedhja e Shabanit si Avokat Populli, Gjykata Kushtetuese rrëzon unanimisht kërkesën e PD: Procesi i r regullt, tërheqja e firmave s'e bllokonte votimin - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/kerkesa-e-pd-per-ligjshmerine-e-shabanit-si-avokat-i-populli-t-sot-shqyrtimi-ne-kushtetuese?r=kh1
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 14:12:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 07:04:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d6fffaea841601008d623d26f6696ab304401e17c10bc47ec6e103356ea48f66f
TEKSTI	b98c9868a8bd2e3e8e0f88f796310fdd06e8f6a33eb4f7bc46fed79fd947e1e1
PAMJA	fb1c64e274d7434d04c7424253dc1e260ac8eb6c215617bcf19907afaaf59e36

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	99f6a5808bbb9f174240c0acc7f7b7fd40ddf6669c54568cd6faaa07c07d87d6
E MËPARSHMJA	a65da6cdf6ea6ee53d3a1038eb6d2f1e1eb15b8ed70a28694448e8c4851a1c2c1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/99f6a5808bbb9f174240c0acc7f7b7fd40ddf6669c54568cd6faaa07c07d87d6

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Lushnjë/ Thahet rezervuari i Kasharajt, tonelata peshqish të ngordhur në sipërfaqe

<>

Politikë

Zgjedhja e Shabanit si Avokat Populli, Gjykata Kushtetuese rrëzon unanimisht kërkesën e PD: Procesi i rregullt, tërheqja e firmave s'e bllokonte votimin

Gjykata Kushtetuese la në fuqi zgjedhjen e Endri Shabanit si Avokat i Popullit, duke rrëzuar unanimisht kërkesën e 44 deputetëve të opozitës. Shabani tha se vendimi i jep fund çdo pikëpyetjeje mbi procedurën e zgjedhjes së tij.

■ Endri Shabani: Vendim i Kushtetueses i jep përgjigje çdo pikëpyetjeje mbi procedurën zgjedhjes së Avokatit të Popullit

■ Kushtetuesja rrëzoi kërkesën e PD për zgjedhjen e Shabanit si Avokat i Popullit, Bardhi: Mashttrimin publik nuk e respektojmë!



Endrit Shabani duke u larguar nga Kuvendi pas betimit, 18 dhjetor 2025



Redaksia

29 Shtator, 09:03 | Përditësimi: 29 Shtator, 16:32

Share Tweet

A A

Gjykata Kushtetuese ka shpallur të ligjshëm emërimin e Endri Shabanit në krye të Avokatit të Popullit, duke rrëzuar në mënyrë unanime kërkesën e 44 deputetëve opozitarë. PD kishte kërkuar që të shpallej antikushtetuese procedura e zgjedhjes së Avokatit të Popullit i cili **u votua me 85 vota pro** në seancën e 11 dhjetorit 2025, ndërsa një javë më pas **u betua mes kaosit të opozitës**.

Një nga pretendimet kryesore të PD kundër procedurës për zgjedhjen e Shabanit lidhej me tërheqjen e firmave të deputetëve opozitarë që kishin mbështetur kandidaturën e Shabanit. Por, Kushtetuesja thotë se kushti i 28 firmave ishte plotësuar kur kandidatura u verifikua nga Komisioni i Ligjeve dhe kaloi për votim në seancë plenare. Sipas Gjykatës, tërheqja e mbështetjes pas kësaj faze nuk mund ta bllokonte procesin.



"Ky kusht ishte plotësuar në momentin e verifikimit nga Komisioni i Ligjeve të kandidaturave dhe kalimin e tyre për votim në seancë plenare. Në këtë mënyrë, procesi kishte sjellë pasoja konkrete, ndaj tërheqja e mbështetjes pas kalimit të kësaj faze nuk mund të sjellë më pasoja në procedurën vijuese parlamentare", thotë Kushtetuesja.



[Sh]
LEXO EDHE:
.com

Kushtetuesja rrëzoi kërkesën e PD për zgjedhjen e



Avokatit të Popullit, Shabani: Vendimi i jep përgjigje çdo pikëpyetjeje mbi procedurën zgjedhjes

Gjykata rrëzoi edhe pretendimin e opozitës se Shabani nuk plotësonte kriterin kushtetues për të pasur “njohuri dhe veprimtari në fushën e të drejtave të njeriut dhe ligjit”. Kushtetuesja vlerësoi se Kuvendi ka hapësirë për të bërë vlerësimin profesional të kandidatëve dhe se në rastin konkret nuk gjeti shkelje të garancive procedurale.



“Në procedurën e ndjekur nga Kuvendi, Gjykata nuk konstatoi cenim të garancive themelore procedurale apo arbitraritet”, thotë Kushtetuesja.

I pabazuar u cilësua edhe pretendimi për veprimtarinë politike të Shabanit.



“Për sa i përket pretendimit për veprimtarinë politike të ushtruar nga kandidati për Avokat të Popullit, Gjykata konstatoi se, në parim, veprimtaria politike, parashikohet nga Kushtetuta si shkak papajtueshmërie, që ndikon në ushtrimin e funksionit. Në rastin konkret, referuar momentit të betimit të Avokatit të Popullit në Kuvend, Gjykata vlerësoi se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar”, vijon Kushtetuesja.

Pretendimet e tjera të opozitës së deputetët do të duhej të mbështesnin vetëm një kandidat, çështjen se si tërhiqet nga rendi i ditës së Kuvend një pikë diskutimi apo votimi, apo faktin se PS nuk respektoi një marrëveshje politike me opozitën sipas së cilës Avokati i Popullit duhet të vijë si kandidat i pakicës parlamentare, Gjykata Kushtetuese nuk i mori fare në shqyrtim pasi sipas saj nuk përbëjnë çështje kushtetuese. Në një reagim, Avokati i Popullit tha se iu dha fund çdo pikëpyetjeje mbi procedurën e zgjedhjes së tij.



NJOFTIM I PLOTË

Në datën 29.09.2026, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me kërkuar një grup prej 44 deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve (kërkuar) me objekt verifikimin e zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të Avokatit të Popullit, përfshirë verifikimin e procedurës së zgjedhjes së tij në detyrë, duke e konstatuar në papajtueshmëri me Kushtetutën, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 111/2025, datë 11.12.2025 të Kuvendit “Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit”.

Gjykata, bazuar në objektin e kërkesës, si dhe natyrën e thelbin e pretendimeve të parashtruara nga kërkuar, vuri fillimisht në diskutim çështjen e juridiksionit të saj për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Gjykata, bazuar në përmbajtjen e shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, vlerësoi, fillimisht, se Avokati i Popullit përfshihet në kategorinë e funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, sipas kësaj dispozite, për rrjedhojë edhe çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të Avokatit të Popullit dhe verifikimin e zgjedhjes së tij përfshihen në juridiksionin kushtetues.

Po në këndvështrim të vlerësimit të juridiksionit të saj, Gjykata, pasi mori në shqyrtim pretendimet e ngritura nga kërkuar, vlerësoi se për: i) nënshkrimet e 28 deputetëve mbështetës në një listë të vetme; ii) mënyrën e zbatimit të rregullit të brendshëm “një deputet mbështet vetëm një kandidat”; iii) interpretimin e nenit 72 të Rregullores të Kuvendit për tërheqjen nga rendi i ditës të projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit; iv) ekzistencën e marrëveshjes politike mes shumicës dhe pakicës parlamentare sipas së cilës Avokati i Popullit duhet të vijë si kandidat i pakicës parlamentare, nuk ngrenë ndonjë çështje të nivelit kushtetues.

Për sa i përket pretendimeve të tjera të kërkuarit për zgjedhshmërinë e Avokatit të Popullit në kuptim të plotësisht të kriterëve kushtetues dhe për papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit, si dhe për verifikimin e zgjedhjes së tij, Gjykata vlerësoi se bëjnë pjesë në juridiksion kushtetues ndaj u ndal në vlerësimin e tyre në themel.

Në lidhje me pretendimin për mosplotësimin e kushtit të zgjedhshmërisë të parashikuar në pikën 2 të nenit 61 të Kushtetutës, sipas të cilit Avokati i Popullit duhet të ketë “njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit”, si dhe hetimin nga Komisioni i Ligjeve në këtë drejtim, Gjykata arriti në përfundimin se Kuvendi në zgjedhjet brenda procedurave parlamentare që përfshijnë vlerësime profesionale të kandidatëve për funksione kushtetuese gëzon diskrecion me kusht që të respektojë garancitë themelore procedurale dhe që procesi mos të ketë arbitraritet. Bazuar në këtë standard, në rastin konkret, në procedurën e ndjekur nga Kuvendi, Gjykata nuk konstatoi cenim të garancive themelore procedurale apo arbitraritet.

Për sa i përket pretendimit për veprimtarinë politike të ushtruar nga kandidati për Avokat të Popullit, Gjykata konstatoi se, në parim, veprimtaria politike, parashikohet nga Kushtetuta si shkak papajtueshmërie, që ndikon në ushtrimin e funksionit. Në rastin konkret, referuar momentit të betimit të Avokatit të Popullit në Kuvend, Gjykata vlerësoi se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

Gjykata gjeti të pabazuar edhe pretendimin tjetër të kërkuarit për verifikimin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, për shkak të mungesës së mbështetjes së deputetëve në momentin e votimit të tij në seancë plenare.

Gjykata vëren, fillimisht, se kërkesa për mbështetjen (propozimin) e kandidatëve nga 28 deputetë nuk është një rregull i përcaktuar nga normat kushtetuese, por i parashikuar në Ligjin Organik të Avokatit të Popullit dhe në Rregulloren e Kuvendit. Qëllimi i rregullit procedural për mbështetjen e kandidatëve nga deputetët është të sigurojë efektivitetin e procedurës parlamentare, në funksion të rezultatit të saj dhe nuk është i lidhur me ushtrimin e funksionit ligjvënës nga Kuvendi. Në rastin në shqyrtim, ky kusht ishte plotësuar në momentin e verifikimit nga Komisioni i Ligeve të kandidaturave dhe kalimin e tyre për votim në seancë plenare. Në këtë mënyrë, procesi kishte sjellë pasoja konkrete, ndaj tërheqja e mbështetjes pas kalimit të kësaj faze nuk mund të sjellë më pasoja në procedurën vijuese parlamentare.

Në përfundim Gjykata njëzëri vendosi rrëzimin e kërkesës.

Vendimi përfundimtar do të shpallet i arsyetuar brenda afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nga Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

NJOFTIM VENDIMMARRJEJE

Në datën 29.09.2026, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me kërkesë një grup prej 44 deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve (kërkuesi) me objekt verifikimin e zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të Avokatit të Popullit, përfshirë verifikimin e procedurës së zgjedhjes së tij në detyrë, duke e konstatuar të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 111/2025, datë 11.12.2025 të Kuvendit "Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit".

Gjykata, bazuar në objektin e kërkesës, si dhe natyrën e thelbin e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, vuri fillimisht në diskutim çështjen e juridiksionit të saj për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Gjykata, bazuar në përmbajtjen e shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, vlerësoi, fillimisht, se Avokati i Popullit përfshihet në kategorinë e funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, sipas kësaj dispozite, për rrjedhojë edhe çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të Avokatit të Popullit dhe verifikimin e zgjedhjes së tij përfshihen në juridiksionin kushtetues.

Po në këndvështrim të vlerësimit të juridiksionit të saj, Gjykata, pasi mori në shqyrtim pretendimet e ngritura nga kërkuesi, vlerësoi se ato për: i) nënshkrimet e 28 deputetëve mbështetës në një listë të vetme; ii) mënyrën e zbatimit të rregullit të brendshëm "një deputet mbështet vetëm një kandidat"; iii) interpretimin e nenit 72 të Rregullores të Kuvendit për tërheqjen nga rendi i ditës të projektvendimit për zgjedhjen e Avokatit të popullit; iv) ekzistencën e marrëveshjes politike mes shumicës dhe pakicës parlamentare sipas së cilës Avokati i Popullit duhet të vijë si kandidat i pakicës parlamentare, nuk ngrenë ndonjë çështje të nivelit kushtetues.

Për sa i përket pretendimeve të tjera të kërkuetit për zgjedhshmërinë e Avokatit të Popullit në kuptim të plotësisht të kriterëve kushtetues dhe për papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit, si dhe për verifikimin e zgjedhjes së tij, Gjykata vlerësoi se bëjnë pjesë në juridiksion kushtetues ndaj u ndal në vlerësimin e tyre në themel.

Në lidhje me pretendimin për mosplotësimin e kushtit të zgjedhshmërisë të parashikuar në pikën 2 të nenit 61 të Kushtetutës, sipas të cilit Avokati i Popullit duhet të ketë "njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut

dhe të ligjit", si dhe hetimin nga Komisioni i Ligeve në këtë drejtim, Gjykata arriti në përfundimin se Kuvendi në zgjedhjet brenda procedurave parlamentare që përfshijnë vlerësime profesionale të kandidatëve për funksione kushtetuese gëzon diskrecion me kusht që të respektojë garancitë themelore procedurale dhe që procesi mos të ketë arbitraritet. Bazuar në këtë standard, në rastin konkret, në procedurën e ndjekur nga Kuvendi, Gjykata nuk konstatoi cenim të garancive themelore procedurale apo arbitraritet.

Për sa i përket pretendimit për veprimtari politike të ushtruar nga kandidati për

Avokat të Popullit, Gjykata konstatoi se, në parim, veprimtaria politike, parashikohet nga Kushtetuta si shkak papajtueshmërie, që ndikon në ushtrimin e funksionit. Në rastin konkret, referuar momentit të betimit të Avokatit të Popullit në Kuvend, Gjykata vlerësoi se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

Gjykata gjeti të pabazuar edhe pretendimin tjetër të kërkuarit për verifikimin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, për shkak të mungesës së mbështetjes së deputetëve në momentin e votimit të tij në seancë plenare.

Gjykata vëren, fillimisht, se kërkesa për mbështetjen (propozimin) e kandidatëve nga 28 deputetë nuk është një rregull i përcaktuar nga normat kushtetuese, por i parashikuar në Ligjin Organik të Avokatit të Popullit dhe në Rregulloren e Kuvendit. Qëllimi i rregullit procedural për mbështetjen e kandidatëve nga deputetët është të sigurojë efektivitetin e procedurës parlamentare, në funksion të rezulttit të saj dhe nuk është i lidhur me ushtrimin e funksionit ligjvënës nga Kuvendi. Në rastin në shqyrtim, ky kusht ishte plotësuar në momentin e verifikimit nga Komisioni i Ligjeve të kandidaturave dhe kalimin e tyre për votim në seancë plenare. Në këtë mënyrë, procesi kishte sjellë pasoja konkrete, ndaj tërheqja e mbështetjes pas kalimit të kësaj faze nuk mund të sjellë më pasoja në procedurën vijuese parlamentare.

Në përfundim Gjykata njëzëri vendosi rrëzimin e kërkesës.

Vendimi përfundimtar do të shpallet i arsyetuar brenda afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nga Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Lajm në përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 16:26

Kushtetuesja rrëzoi kërkesën e PD për zgjedhjen e Endri Shabanit si Avokat i Popullit, Bardhi: Gjykatë që s'bën drejtësi, por politikë



Foto: Gazment Bardhi

Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën e deputetëve të Partisë Demokratike, të cilët kundërshtonin zgjedhjen e Endri Shabanit në detyrën e Avokatit të Popullit.

Pas këtij vendimi ka reaguar Kreu i Grupit Parlamentar, Gazment Bardhi. Në një postim të gjatë në rrjetet sociale Bardhi shpreh se Kushtetuesja mund të kishte deklaruar vetëm që *'kërkesa u rrëzua për qëllime politike, pa pasur nevojë të mashtrohet publikisht'*.

Sipas Bardhit ata do të respektonin çdo vendim që do të merrte Kushtetuesja, përveç mashtimit publik. Ai nënvizon se një Gjykatë që i shmanget transparencës dhe që mashtrohet opinionin publik mbi fakte të njohura publikisht, nuk bën drejtësi, por politikë.

Reagimi i Gazment Bardhit:

Mund të kishin thënë thjesht "rrëzohet", për qëllime politike, pa pasur nevojë të mashtrohet publikisht. Në çdo rast, çfarëdo lloj vendimi që do të merrte Gjykata Kushtetuese, ne do ta respektonim di të detyrueshëm për zbatim. Por mashtrimin publik nuk e respektojmë dot; përkundrazi, e përbuzim me përçmim.

Dënoj me forcë shtrembërimin e fakteve dhe provave nga Gjykata Kushtetuese. Një gjykatë që deformon faktet, humbet besueshmërinë.

Gjykata Kushtetuese, në njoftimin publik për arsyet e rrëzimit të kërkesës së Grupit Parlamentar të PD-së për paligjshmërinë e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, shprehet se: "Në rastin në shqyrtim, ky kusht ishte plotësuar në momentin e verifikimit nga Komisioni i Ligjeve të kandidaturave dhe kalimin e tyre për votim në seancë plenare. Në këtë mënyrë, procesi kishte sjellë pasoja konkrete, NDAJ TËRHEQJA E MBËSHTETJES PAS KALIMIT TË KËSAJ FAZE nuk mund të sjellë më pasoja në

proceduren vijuese parlamentare. .

Ky është thjesht një mashtim publik, që vendos në pikëpyetje të fortë kushtetutshmërinë e vendimmarrjes së Gjykatës në rastin konkret.

Grupi Parlamentar i PD-së ka tërhequr mbështetjen në datën 5 dhjetor 2025, përmes shkresës nr. 3853 Prot., datë 05.12.2026. Ndërkohë, Komisioni i Ligjeve ende nuk kishte bërë atë që Gjykata thotë se e kishte bërë: verifikimin e kandidaturave dhe kalimin e tyre për votim në seancë plenare. Verifikimi nga Komisioni i Ligjeve i kandidaturave dhe kalimi i tyre për votim në seancë plenare është bërë në mbledhjen publike të Komisionit në datën 9 dhjetor 2025, pra 4 ditë pas tërheqjes së mbështetjes.

Mashtimi publik i Gjykatës Kushtetuese për akte dhe fakte që janë të njohura botërisht, lehtësisht të verifikueshme, justifikon edhe arsyet jokushtetuese të Gjykatës Kushtetuese për të mos pranuar kërkesën tonë që çështja të shqyrtohej në seancë plenare publike, transparente dhe që opinionin publik të kishte mundësi të njihet me rrethanat e çështjes.

Një Gjykatë që i shmanget transparencës dhe që mashtroi opinionin publik mbi fakte të njohura publikisht, nuk bën drejtësi, por politikë. Kjo është thjeshtë e papranueshme për një shtet ligjor!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.